



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01 Nr. 16-30267 /14
Kaçanik, 07.10.2014

KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK

SHËRBIMI PËR PUNË PROFESIONALE TË KUVENDIT

BULETINI **PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS** **01.01.2013- 20.12.2013**

Kaçanik, 2014

H Y R J E

Ky Buletin përfshinë Aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në periudhën kohore, 01.01.2013 – 20.12.2013.

Buletini është përpiluar nga Shërbimi për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer Procesverbalet e përpiluara gjatë punës së Kuvendit.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktivitetit të kuvendit të komunës për gjatë kësaj periudhës njëvjeçare, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jetë sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit është mirënjohës për vërejtjet dhe sugjerimet që do të jepen në të. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti në punën e ardhshme të jetë sa më i suksesshëm dhe cilësor.

PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dalë nga Zgjedhjet e datës 15.11.2009, numëron gjithsej 27 anëtarë.

Përbërja e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në vitin 2013, është si vijon:

Nr. rend	Emri dhe Mbiemri	Pozita
1.	Xhelal Gashi	PDK
2.	Ilaz Ceka	PDK
3.	Tefik Vishi	PDK
4.	Ramadush Osmani	PDK
5.	Afrim Bunjaku	PDK
6.	Kemajl Murseli	PDK
7.	Driton Thaqi	PDK
8.	Krenare Luzha	PDK
9.	Zekirja Loku	PDK
10.	Habib Guri	PDK
11.	Florije Dalloshi	PDK
12.	Arbnora Sallahu	PDK
13.	Diana Bajrami	PDK
14.	Shiqeri Luzha	AAK
15.	Shukri Luta	Pavarur
16.	Hajdar Loku	AAK
17.	Rami Çaka	AAK
18.	Sevdije Frangu	AAK
19.	Nerimane Lika	AAK
20.	Afërdita Deda	AAK
21.	Daut Rudi	LDK
22.	Ibrahim Hoxha	LDK
23.	Nazife Krasniqi	LDK
24.	Florijeta Gashi	LDK
25.	Ali Krasniqi	AKR
26.	Sherife Troni	AKR
27.	Elife Murseli	LDD

Me Kuvendin e Komunës udhëheq, Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit.

Në ndërkohë kjo përbërje e Kuvendit të Komunës pëson ndryshime me atë që, **Aferdita Deda** dhe **Nerimane Lika** japin dorëheqje, dhe në vend të tyre caktohen **Nerxhivane Gula** dhe **Engjëllushe Dashi**.

Gjatë vitit 2013, Kuvendi i Komunës ka pasur ndryshime edhe në përbërjen e spektrit politik, ashtu që anëtarja, **Sherife Troni** nga subjekti politik i AKR, kalon në subjektin politik të AAK.

Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa(KPF)

Nr. ren.	Emri dhe Mbiemri	subjekti	pozita
1.	Xhelal Gashi	PDK	kryesues
2.	Zekirja Loku	PDK	anëtar
3.	Arbnora Sallahu	PDK	anëtare
4.	Kemajl Murseli	PDK	anëtar
5.	Shyqeri Luzha	AAK	anëtar
6.	Rami Çaka	AAK	anëtar
7.	Daut Rudi	LDK	anëtar

Komitetit për Komunitete kishte këtë përbërje;

Nr. ren.	Emri dhe Mbiemri	subjekti	pozita
1.	Rami Çaka	AAK	anëtar
2.	Ibrahim Hoxha	LDK	anëtar
3.	Sherife Troni	AKR- AAK	anëtare
4.	Bahrije Çaka	shoqëria civile	anëtar
5.	Bislim Krasniqi	shoqëria civile	anëtar

Përbërja e Ekzekutivit të Komunës:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita
1.	Besim Ilzai	Kryetar i Komunës
2.	Remzi Elezi	Nënkryetar i Komunës
3.	Jeton Topalli	Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme(DAP),
4.	Misim Sopa	Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale(DSHMS)
5.	Fikri Verbani	drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim(DEFZH)
6.	Azem Guri	Drejtor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë(DAK)
7.	Bekim Troni	Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(DUKMM)
8.	Rushan Ceka	Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë(DSHPE)
9.	Nuhi Provoliu	Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari(DBZHRP)

Në ndërkohë drejtorët e drejtorive të Komunës, **Azem Guri** dhe **Nuhi Provoliu** ofrojnë dorëheqje, dhe në vend të tyre caktohen për ushtrues detyre: **Avni Krasniqi** dhe **Zylfi Koxha**.

AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Viti 2013

Mbledhja I

Me 31.01.2013, është mbajtur mbledhja e I-rë e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2013,
2. U debatua Plani i Punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2013,
3. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e bursave për studentë të komunës, dhe
4. Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga viti 2012 në vitin buxhetor 2013.

Mbledhja II

Me 11.02.2013, është mbajtur mbledhja e II-të e radhës (Mbledhje e Jashtëzakonshme) e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për Lejimin e mjeteve buxhetore për shënimin e festës së Pavarësisë së Kosovës, dhe
2. Vendimi për caktimin e Lokacionit për Ndërtimin e Palestrës Sportive në Kaçanik. në pjesën e parcelës kadastrale **nr. 00005-0**, vendi i quajtur “Dushkaja” me kulturë maden rëre me sipërfaqe prej **01.02.89 ha** dhe parcela kadastrale **nr. 00006-0**, vendi i quajtur “Dushkajë”, me kulturë greminë, me sipërfaqe prej **0.13.73 ha**, Certifikata-Fleta Poseduese **nr. 86**, Zona Kadastrale Kaçanik, në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Kaçanik.

Mbledhja III

Me 26.03.2013, është mbajtur mbledhja e III e radhës (II e Rregullt) e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. E jep Betimi Solemn anëtarja e zgjedhur të Kuvendit të Komunës, Nerxhivane Gula, pas dorëheqjes së Afërdita Deda,
2. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2012,
3. U debatua Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2012,
4. Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Stacioni i Autobusëve” në përbërje;
 1. Menduh Krasniqi, anëtar i caktuar nga Kryetari i Komunës,
 2. Driton Thaqi, anëtar nga PDK, dhe
 3. Hajdar Loku, anëtar nga AAK.
5. Vendimi për Lejimin e mjeteve buxhetore për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të udhëtimit të disa nxënësve të shkollave të mesme, nxënësve më nevoja të veçanta dhe lejimin e mjeteve buxhetore për aktivitete kulturore, dhe
6. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të DBZHRP.

Mbledhja e IV e radhës (III e Rregullt)

Me 29.04.2013, është mbajtur mbledhja e IV e radhës, respektivisht e III e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. U debatua Raporti i Punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2012,
2. U debatua Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit për periudhën janar-mars, 2013,
3. Propozim Rregullorja për Barazi Gjinore, i kthehet propozuesit për përpunimin e saj,
4. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, i dërgohet Zyrës Ligjore të MAPL, me Kërkesë për shqyrtim paraprak,
5. Vendimi për Hartimin e Planit Rregullues Urban për zonën e II-të dhe zonën e III-të urbanistike të qytetit të Kaçanikut.

Mbledhja e V e radhës (e IV e Rregullt)

Me 31.05.2013, është mbajtur mbledhja e V e radhës, respektivisht e IV e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për Aprovimin e Statutit të Qendrës për Punës Sociale në Kaçanik,
2. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për Barazi Gjinore,
3. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 05-16-883/2011, për ndalimin e organizimit të lojërave të fatit në territorin e komunës së Kaçanikut,
4. U njoftua Kuvendi i Komunës me Informatën e Komisionit për Krimet e Luftës, në vitet, 1998/1999, në Komunën e Kaçanikut.

Mbledhja e VI e radhës (e II e Jashtëzakonshme)

Me 12.06.2013, është mbajtur mbledhja e VI e radhës, respektivisht e II e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për Rishikimin e Buxhetit të komunës për vitin 2013.

Mbledhja e VII e radhës (V e Rregullt)

Me 04.07.2013, është mbajtur mbledhja e VII e radhës, respektivisht e V-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. E jep Betimi Solemn anëtarja e zgjedhur të Kuvendit të Komunës, Engjëllushe Dashi, me rastin e dorëheqjes se Nerimane Lika,
2. Vendimi për prolongim të propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,
3. Vendimi për aprovimin e Statutit të Ndërmarrjes Publike Komunale”Stacioni i Autobusëve” sh. a. Kaçanik,
4. Vendimi për vazhdimin e Lejes së ndërtimit 06. Nr. 90/2007 i datës 18.12.2007, për ndërtimin e Hidrocentralit 3, në pasurinë shoqërore Ujërat, Zona Kadastrale Sllatinë,

5. Vendimi për caktimin e tarifës për lëshimin e Vërtetimit që komuna nuk është e interesuar për blerjen e ngastrave të ndryshme në territorin e komunës,
6. Vendimi për Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për ndërtimin-rregullimin e varrezave të dëshmorëve, dhe
7. Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01 Nr. 05-8253/2010- Për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e komunës së Kaçanikut.

Mbledhja e VIII e radhës(VI e Rregullt).

Me 29.07.2013, është mbajtur mbledhja e VIII e radhës, respektivisht e VI-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për aprovimin e Rregullores për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga Stacioni i Autobusëve,
2. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01Nr. 16-27192/12- Për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve,
3. U debatua Raporti i ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-qershor, 2013;
4. Vendimi për aprovimin e Kornizës afatmesme buxhetore të komunës së Kaçanikut për vitet, 2014-2016,
5. U debatua Raporti i Auditimit mbi pasqyrat financiare të komunës së Kaçanikut, për vitin e përmbyllur me 31 dhjetor 2012, dhe
6. Vendimi për Konfirmimin e vazhdimit të Marrëveshjes së Partneritetit të Komunës së Kaçanikut me Komunën e Moosseedorf të Zvicrës.

Mbledhja e IX e radhës(VII e rregullt)

Me 27.09.2013, është mbajtur mbledhja e IX e radhës, respektivisht e VII e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për aprovimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2014 dhe vlerësimet për vitet 2015-2016,
2. Vendimi për aprovimin e Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2014,

3. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për fuqizimin dhe promovimin e punës vullnetare të të rinjve në komunën e Kaçanikut,
4. Vendimi për ndryshimin e shumave të ndara për projektet kapitale sipas ndarjeve me buxhetin e komunës për vitin 2013.
5. Vendimi për mbështetje financiare të KF” Lepenci” në Kaçanik,
6. Vendimi për shpalljen e Zonave Industriale në komunën e Kaçanikut,
7. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit 0. Nr. 02-07-554/06 për lejimin e lokacionit për ndërtimin e kazermës për nevoja të TMK-së, dhe
8. Vendimi për aprovimin e Planit të Veprimit për Rekomandimet zbatuese në Raportin Vjetor të Auditimit 2012.

MBLEDHJE SOLEMNE

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, gjatë vitit 2013, ka mbajtur tri mbledhje me karakter Solemn dhe atë; me datë 17.02.2013, një mbledhje Solemn i kushtohet, Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Me 11.06.2013, një mbledhje Solemn i kushtohet, Ditës së Çlirimit të Komunës dhe më datë 10 gusht 2013, një mbledhje Solemn i kushtohet, Ditës së Dëshmorëve të Komunës.

DEBATE PUBLIKE

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, gjatë vitit 2013, ka organizuar dhe mbajtur Debate publike me qytetarë të komunës për çështje të përgjithshme, dhe për çështje të veçanta, si për Buxhetin e komunës dhe për çështje tjera më rëndësi për komunën.

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

Monitorimi i mbledhjeve të rregullta të kuvendit nga strukturat vendore është bërë nga MAPL-a, përmes Teleprezencës, ndërsa nga strukturat ndërkombëtare, mbledhjet e rregullta të Kuvendit, janë monitoruar nga OSBE-a. Mbledhjet janë monitoruar edhe nga KDI.

Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës janë mbajtur me 03.11.2013.

Fushat Zgjedhore ka filluar nga data 03.10.2013 deri më 01.11.2013.

Në këto Zgjedhje është votuar për:

1. Kryetarë të Komunave, dhe
2. Kuvendet Komunale.

Anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut të Legjislaturës së IV të zgjedhur në votimet e datës 15.11.2009, iu ka pushuar Mandati me marrjen e mandatit të anëtarëve të Legjislaturës së V respektivisht me datë 20.12.2013, me përjashtim të anëtarëve të cilët janë rizgjedhur në zgjedhjet e 03 Nëntorit 2013.

Anëtarët e rizgjedhur në Zgjedhjet e datës 03 Nëntorit 2013;

Nr. rend	Emri dhe Mbiemri
1.	Xhelal Gashi
2.	Ilaz Ceka
3.	Kemajl Murseli
4.	Arbnora Sallahu-Kuka
5.	Shukri Luta
6.	Hajdar Loku
7.	Nazife Krasniqi
8.	Sherife Troni

Përgatiti: Makfire Malsiu,
Zyrtare e Kuvendit